

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Debat i ri mes Greqisë dhe Turqisë, Ankaraja sfidon planin e Athinës, çfarë po ndodh mes dy vendeve – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/debat-i-ri-mes-greqise-dhe-turqise-ankaraja-sfidon-planin-e-at-hines-cfare-po-ndodh-mes-dy-vendeve/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 05:13:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	30 gusht 2026, 06:21:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e14dfe4f01a69c1e270560df031ef71790fb533b077a5f880f71dd613d116ee
TEKSTI	8d32a799692a4c7fb1fce890c9249c32ae8b97f53e1bedb895c4278af68d6187
PAMJA	147e4427ed00ceae5dfcb3849a013a6be32821c1868add16bb8200c2dbeade17

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5eeab274c0edd6de38af51a8962fd2478fa34486298be9c8ca3e28619bb397eb
E MËPARSHMJA	38349aca0deaa2f9d969fac81a2bb0a63e198762fe2efcfc9d97af6a5d7073de
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5eeab274c0edd6de38af51a8962fd2478fa34486298be9c8ca3e28619bb397eb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



këtë herë me shkak një plan të ri të Athinës për zhvillimin e industrisë dhe të qendrave të furnizimit në territorin grek.

Plani i ri hyri në fuqi ditën e djeshme dhe përcakton se në cilat zona mund të zhvillohen aktivitete industriale, ku mund të krijohen zona biznesi dhe logjistike dhe cilat rregulla duhet të respektohen për mbrojtjen e mjedisit. Por reagimi i Turqisë erdhi për faktin se ky plan përfshin edhe ishuj dhe zona të Egjeut.

Ministria e Jashtme turke deklaroi se vendimet e Greqisë nuk krijojnë pasojë juridike për Turqinë dhe përsëriti një nga qëndrimet e vjetra të Ankarasë: se në Egje ekzistojnë disa ishuj të vegjël dhe formacione gjeografike, sovraniteti i të cilave, sipas palës turke, nuk i është kaluar Greqisë me traktate ndërkombëtare.

Athina reagoi menjëherë dhe me tone të ashpra. Ministria e Jashtme greke i cilësoi pretendimet turke “të pabazuara dhe të papranueshme”.

Sipas Athinës, fakti që Turqia përsërit të njëjtin qëndrim sa herë Greqia miraton një plan të ri territorial, nuk i jep këtij pretendimi as bazë juridike dhe as vlefshmëri.

Qeveria greke theksoi gjithashtu se çështja e sovranitetit në Egje është e qartë dhe përcaktohet nga traktatet ndërkombëtare në fuqi. Sipas saj plani i ri grek nuk është një plan ushtarak dhe nuk përcakton kufij të rinj. Ai është në thelb një plan ekonomik dhe urbanistik, që tregon se ku dhe me çfarë kushtesh mund të zhvillohen industria, bizneset dhe qendrat e shoërndaries së mallrave.

5 Elbasani nuk tanëgnatla peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emëlli juaj

Abonohu

Për shembull, në Athinë dhe Selanik kufizohet krijimi i fabrikave të reja jashtë zonave të organizuara industriale, ndërsa për ishujt parashikohen rregulla të veçanta, për shkak të hapësirës së kufizuar dhe nevojës për mbrojtjen e mjedisit. Pra, thelbi i përplasjes nuk është vetë industria thekson Athina duke nënvizuar se po vendos rregulla për zhvillimin ekonomik brenda territorit të saj. Turqia, nga ana tjetër, thotë se përfshirja e disa zonave të Egjeut në dokumentet greke nuk mund të konsiderohet si provë juridike e sovranitetit grek mbi to.

Megjithatë, krahas toneve të forta, Ankaraja la të hapur edhe derën e dialogut. Ministria e Jashtme turke deklaroi se vazhdon të mbështesë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë sipas Deklaratës së Athinës të dhjetorit 2023 dhe se Turqia mbetet e gatshme për bashkëpunim me Greqinë.

Ky është episodi i dytë i tensionit brenda pak ditësh, pas përplasjes së Athinës dhe Ankarasë sa u përket planeve greke për energjinë e rinovueshme dhe parqet detare në Egje, kur Turqia ngriti sërish çështjen e sovranitetit mbi disa ishuj dhe formacione gjeografike.

#Greqi

#Turqi




Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Sulm me dron ndaj një anijeje ruse në Detin...

Xhuljana Zhuleku 56 minuta më parë



BOTA

Trump i kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana Zhuleku 2 orë më parë



BOTA

Tragjedi! Përmbysset anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku Dje 23:17



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑